
THE RELATIONSHIP AND INTERACTION BETWEEN ECONOMIC DEVELOPMENT AND EMERGENCY MANAGEMENT

Shyqeri Kabashi

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, kbiznesi@gmail.com

Abstract: Relationships - Mutual cooperation, assistance and interaction between two or more people, parties, states, organizations, etc. in a field of political, social, economic activity or in various jobs.

Interaction - Mutual relationship and dependence between beings, things or phenomena; close relationships between two or more people living or working together or having similar thoughts or goals.

Natural and convenient coordination between parts of something, a well-proportioned and well-proportioned union of the constituent elements of something; complete reconciliation between two things, mutual reconciliation according to a certain proportion.

Mutual action that exercises two different things or phenomena, interaction. Interaction of socio-economic factors. Interaction between literary language variants.

Development - The degree of social awareness and mental abilities, education, culture, moral perfection, etc. that one has achieved; the degree of progress that has been made in each of the different areas of social activity and society as a whole. (SFRY, p. 2271) Development is a multi-dimensional process that usually means a change from a less desirable state to a more desirable state. Development is a normative concept, and there is not a single definition all of it accepted. Some say that development must be time-bound, place-specific, and circumstantial, and cannot be simplified into a fully acceptable formula. Increasing economic effects, expanding the productive capacity of a country's economy, and technological advancement are generally accepted as indispensable conditions for development to be long-term and continuous, as well as industrial diversity and adaptability to external shocks. Economic development cannot be separated from other aspects of development, but its greatest value may be that it expands the range of human choices.

Economic - Concerning the organization and direction of the economy, related to the material and financial situation of a country, a province, a branch of social production, a production enterprise, etc. ; that has to do with a country's economy.

Management - A conscious orientation process through which management personnel organize and orchestrate emergency force units, according to a common task for a common purpose, coordinating the various resources in the process of planning, organizing, developing and controlling.

Emergency - Critical situation, difficult period. Dangerous situation for the lives of the people and the property of the citizens and the public, created as a result of the occurrence of a disaster and the consequences that it has on the lives of the citizens of the affected region; which calls for accelerated and multiple measures and actions to overcome the situation and restore normalcy to the life of the country. Immediate and coordinated response, all the resources and forces necessary or possible to restore normalcy. Putting into operation all the central and local capacities of a country for saving the lives of citizens, protecting material goods and public health or for avoiding or reducing the consequences of disaster in any part of the country. Organizing and acting to cope with the consequences of disaster and liquidating these consequences and restoring normalcy to the life of the country.

Keywords: economic development, emergency management, Kosovo

MARRËDHËNIA DHE NDËRVEPRIMI MIDIS ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE

Shyqeri Kabashi

Kolegji "BIZNESI" Prishtinë, Kosovë, kbiznesi@gmail.com

Përmbajtja: Marrëdhënie - Lidhje e ndërsjellë bashkëpunimi, ndihme e bashkëveprimi ndërmjet dy a më shumë njerëzve, palëve, shteteve, organizatave etj. në një fushë të veprimtarisë politike, shoqërore, ekonomike a në punë të ndryshme.¹

¹ <https://sq.wiktionary.org/wiki/marr%C3%ABdh%C3%ABnie> (05.10.2019)

Ndërveprim - Marrëdhënie e varësi e ndërsjellë ndërmjet qenieve, sendeve ose dukurive; marrëdhënie të afërta ndërmjet dy a më shumë vetave që jetojnë a punojnë së bashku ose që kanë mendime të njëjta a synime të përbashkëta.

Bashkërendim i natyrshëm dhe i përshtatshëm ndërmjet pjesëve të diçkaje, bashkim i qëlluar dhe i përpjesëtuar mirë i elementeve përbërëse të diçkaje; pajtim i plotë ndërmjet dy gjërave, përputhje e dyanshme sipas një përpjesëtimi të caktuar.²

Veprim i ndërsjellë që ushtrojnë mbi njëra-tjetrën dy gjëra ose dukuri të ndryshme, bashkëveprim. Ndërveprimi i faktorëve ekonomiko-shoqërorë. Ndërveprimi midis varianteve të gjuhës letrare.³

Zhvillim – Shkalla e vetëdijes shoqërore dhe e aftësive mendore, e arsimit, e kulturës, e përsosjes morale etj që ka arritur dikush; shkalla e përparimit që ka arritur njëra a tjetra nga fushat e ndryshme të veprimtarisë shoqërore dhe shoqëria në tërësi. (FGJSSH, f. 2271) Zhvillimi është një proces shumë përmasash që zakonisht do të thotë ndryshim nga një gjendje më pak e dëshirueshme në një gjendje më shumë të dëshirueshme. Zhvillimi është një koncept normativ, dhe nuk ka një përcaktim të vetëm të gjithë pranuar të tij. Disa thonë se zhvillimi duhet të jetë i lidhur me kohën, me vendin dhe me rrethanat, dhe nuk mund të thjeshtohet në një formulë të gjithë pranueshme. Shtimi i efekteve ekonomike, zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të ekonomisë së një vendi dhe përparimi teknologjik pranohen përgjithësisht si kushte të domosdoshme që zhvillimi të jetë dukuri afatgjatë dhe e vazhdueshme, po ashtu si diversiteti industrial dhe përshtatshmëria ndaj tronditjeve të jashtme. Zhvillimi ekonomik nuk mund të ndahet nga aspektet e tjera të zhvillimit, por vlera e tij më e madhe mund të jetë se ai zgjeron gamën e mundësive të njeriut për të zgjedhur.⁴

Ekonomik – Që ka të bëjë me organizimin dhe me drejtimin e ekonomisë, që lidhet me gjendjen materiale e financiare të një vendi, të një krahine, të një dege të prodhimit shoqëror, të një ndërmarrjeje prodhimi etj; që ka të bëjë me ekonominë e një vendi.⁵

Menaxhim – Procesi i orientimit të vetëdijshëm përmes të cilit personeli drejtues i organizon dhe i orienton njësitë e forcave të emergjencave, sipas detyrës së përbashkët për një qëllim të përbashkët, duke koordinuar burimet e ndryshme në procesin e planifikimit, organizimit, zhvillimit dhe kontrollit.⁶

Emergjencë – Situatë kritike, periudhë e vështirë. Situatë e rrezikshme për jetën e njerëzve dhe pasurinë e qytetarëve e atë publike, që krijohet si rrjedhojë e ndodhjes së një katastrofe dhe të pasojave që ajo ushtron mbi jetën e qytetarëve të rajonit të goditur; në të cilën kërkohet të ndërmerren masa dhe veprime të përshepuara dhe të shumëfishta për ta tejkaluar situatën dhe për të rivendosur normalitetin në jetën e vendit. Reagim të menjëhershëm dhe të bashkërenduar, i të gjitha resurset dhe forcat e mjetet e nevojshme ose të mundshme për të rikthyer normalitetin. Vënia në veprim i të gjitha kapaciteteve qendrore e lokale të një vendi për shpëtimin e jetëve të qytetarëve, mbrojtjen e të mirave materiale dhe shëndetit publik apo për shmangien ose zvogëlimin e pasojave të katastrofës në çdo pjesë të vendit. Organizimi dhe veprimi për të përballuar pasojat e katastrofës dhe likuiduar këto pasoja e rikthimin e normalitetit në jetën e vendit.⁷

Fjalë kyçe: zhvillimi ekonomik, menaxhimi i urgjencës, Kosova

1. ZHVILLIM EKONOMIK DHE MENAXHIM I EMERGJENCAVE

Për të lumturuar qytetarët e vendit është i nevojshëm zhvillimi ekonomik. Por që të kemi zhvillim ekonomik të sigurt, duhet të organizojmë në perfeksion menaxhimin e emergjencave. E që të kemi një menaxhim emergjencash me vlerë për sigurinë e zhvillimit, duhet të analizohen e vlerësohen me kujdes rreziqet, që mund të bëhen shkas për fatkeqësi në shoqëri e në mjedis.

Përcaktimi i një synimi të tillë kërkon politikë stabile e me vullnet dhe plane afatgjata të zhvillimit të vendit. Prandaj duhet të dimë në radhë të parë se një ekonomi e zhvilluar nuk mund të arrihet me një politikë destabiliteti e klanore dhe me plane deklarative fushatash.

² <https://sq.wiktionary.org/wiki/lidhje> (05.10.2019)

³ <https://sq.wiktionary.org/wiki/nd%C3%ABrveprim> (05.10.2019)

⁴ Kabashi Dr, Shyqeri – Shehu Dr. Izet – Lama Dr. Kudusi, Fjalor shpjegues i termave të menaxhimit të emergjencave, Kolegji BIZNESI, Prishtinë më, 2015, faqe 820 - 821

⁵ Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë më, 1980, faqe 418 - 419

⁶ Kabashi Dr, Shyqeri – Shehu Dr. Izet – Lama Dr. Kudusi, Fjalor shpjegues i termave të menaxhimit të emergjencave, Kolegji BIZNESI, Prishtinë më, 2015, faqe 477 - 478

⁷ Po Aty, faqe 201 - 202

Vlerësohet se “rreziku më i lartë duket se vjen nga dobësimi i rritjes ekonomike...”⁸ E ky dobësim bën që të mos kemi një ekonomi solide, të mos kemi një zhvillim të dukshëm, të mos kemi një prani të përvojave të përparuara të vendeve të zhvilluara, të mos kemi as mundësi për të treguar se çfarë po bëjmë dhe as se ku synojmë të arrijmë. Këto dukuri nëjnë të bëhemi të brishtë, të bëhemi mashtrues, të bëhemi jo serioz, të bëhemi të pa besueshëm, të bëhemi lypsarë, të bëhemi pastrues të vendit nga rinia dhe forca e aftë për punë, si dhe të bëhemi më në fund të pa dëshiruar prej askujt.

Për të pasur zhvillim ekonomik të nivelit bashkëkohor kërkohet politikë e brendshme e paqëndrueshme, pa tensione sociale që të mos pengojnë ecurinë e zbatimit të reformave strukturore dhe axhendës së konsolidimit fiskal. “Zbatimi i reformave, duke përfshirë ato për të forcuar sundimin e ligjit janë kyçe për rritjen ekonomike në periudhën afatmesme rritjen dhe perspektivat e bisedimeve për pranimin në BE”.⁹ Por mbi këto kërkohet që të kemi vëmendjen e shtuar edhe mbi rreziqet, që mund të na e dëmtojnë ekonominë dhe të na lëshojnë në zero edhe kur mund të jemi ngjitur në nivele të larta. Kjo do të ishte një lloje sikur të kemi shtëpinë të muluar me kashtë dhe të ndezim sjarr në oborr, kur është duke fryrë erë e fortë.

Kështu, kushtet klimatike, që nuk varen nga ne mund të jenë shkatërruese nëse nuk merren masat e nevojshme të vlerësimit të rrezikut dhe masat e tjera parandaluese të kthimit të tyre në kërcënime a fatkeqësi për vendin, duke rënuar zhvillimin ekonomik dhe jetën e qytetarëve. Të tilla mund të jenë temperaturat e larta dhe thatësitat në verë; ashtu reshjet e shirave të rrëmbyeshme në pranverë e në vjeshtë etj.

2. RESHJET, KOSTOT DHE PËRFITIMET NË EKONOMI

Gjithnjë do të kemi pasoja që do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik nga ndryshimi i klimës në jetën ekonomike dhe sociale të vendit në vitet e ardhshme. Dhe ky nuk është thjeshtë një lajmërim por që rezultojnë tërësisht i vërtetë. Ndryshimet ekstreme të klimës me thatësira dhe reshje të dendura, kanë mundësinë t'i krijojnë ekonomisë sa kosto edhe përfitime. Kostot lidhen me dëmet në ekonominë e familjeve të përmbytura dhe kulturat bujqësore të zonës dhe përfitimet nga prodhimi i energjisë në vend, që është një vlerë e shtuar me mjaft ndikime pozitive në ekonominë e përgjithshme të vendit, kur kemi hidrocentrale për të prodhuar energji. Ashtu sikurse mund të mbushen edhe ujëmbledhësit, kur kemi të tillë për vaditje.

Përmbytja në fillim të pranverës, vjen me kosto më të mëdha për bujqësinë. Për shkak se një pjesë e tokave tashmë janë të mbjella me kulturat e pranverës dhe pjesa tjetër ishte në përgatitje për mbledhjet e sezonit të verës, që zakonisht ndodhin në këtë periudhë. Ekspertët e Bujqësisë i llogarisin dëmet në këtë sektor të pallogaritshme, nëse përmbytjet vërshojnë edhe në sipërfaqe toke, duke krijuar situata të shtrirjes së ujit në sipërfaqe të mbjella. Bujqësia në këtë periudhë është e zhvilluar ndjeshëm dhe përfaqëson kultura të shumëllojshme, që nga perimet, zarzavatet, gruri, misri etj. Reshjet në këtë periudhë plus që do të vonojnë në mbjelljen e kulturave të pranverës, do të bëjnë të papërdorshme dhe për disa kohë tokën e përmbytur. Por dëmet financiare të këtyre reshjeve përveçse në bujqësi janë edhe me natyrë materiale, për bizneset dhe familjet e zonës së përmbytur. Prandaj mund të thuhet se ndryshimet klimatike janë kërcënim serioz dhe problem i rëndësishëm për bujqësinë, resurset e ujit, sigurinë ushqimore, jetesën rurale dhe ulje të varfërisë në Kosovë. Ndikimi i tyre do të reflektohet mbi banorët në mjediset të cilat janë të varura drejtpërdrejt nga prodhimtaritë bujqësore. Por njëkohësisht vlerësohet se “sipas analizave të Bankës Botërore, si rezultat i ndryshimeve klimatike, janë rritur temperaturat, ka deficite të lagështirës. Zjarret në pyje janë më të shpeshta dhe ka ekspozim më të madh të dëmtuesve të rinj dhe sëmundjeve të kulturave bujqësore, pyjeve dhe kafshëve”.¹⁰

3. ROLI I SHTETIT NË EKONOMI

Në të gjitha ekonomitë moderne, shteti ka një rol të padiskutueshëm, e madje shpesh parësor në aktivitetin ekonomik. Detyra themelore e shtetit në raport me ekonominë e cdo vendi është krijimi dhe mbarëvajtja e funksionimit të platformës ligjore dhe institucionale mbi të cilën zhvillohet aktiviteti ekonomik. Ekonomistët sot dallojnë disa faktorë të rëndësishëm që justifikojnë pjesëmarrjen e shtetit në aktivitetin ekonomik, të tilla si:¹¹

Mosfunksionimi në përsosmëri i tregut. Krizat ekonomike që përsëriten rregullisht diktojnë qartë nevojën e ndërhyrjes nga ana e shtetit për të kapërcyer dështimin e përkohshëm në funksionimin e mekanizmit të tregut.

⁸[https://www.monitor.al/dobesimi-i-rritjes-ekonomike-dhe-trazirat-politike-demin-me-te-larte-ne-ekonomi/\(16.09.2019\)](https://www.monitor.al/dobesimi-i-rritjes-ekonomike-dhe-trazirat-politike-demin-me-te-larte-ne-ekonomi/(16.09.2019))

⁹[https://www.monitor.al/dobesimi-i-rritjes-ekonomike-dhe-trazirat-politike-demin-me-te-larte-ne-ekonomi/\(16.09.2019\)](https://www.monitor.al/dobesimi-i-rritjes-ekonomike-dhe-trazirat-politike-demin-me-te-larte-ne-ekonomi/(16.09.2019))

¹⁰ Hoxha Blerina, [https://www.monitor.al/reshjet-kostot-dhe-perfitimet-ne-ekonomi/\(21.09.2019\)](https://www.monitor.al/reshjet-kostot-dhe-perfitimet-ne-ekonomi/(21.09.2019))

¹¹ [https://shtetiweb.org/2012/12/29/roli-i-shtetit-ne-ekonomi/\(25.10.2019\)](https://shtetiweb.org/2012/12/29/roli-i-shtetit-ne-ekonomi/(25.10.2019))

Nevoja e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve publike. Shteti përgjithsisht merr përsipër ofrimin për qytetarët e tij të atyre të mirave e shërbimeve, të cilat përfitohen në mënyrë të njëjtë nga të gjithë qytetarët e në një pjesë të madhe, pa pagesë të drejtpërdrejtë.

Funksionimi i shtetit si agjent prodhues i të mirave materiale dhe shërbimeve. Krahas rolit të pazëvendësueshëm në krijimin dhe mbarëvajtjen e platformës ligjore mbi të cilën zhvillohet aktiviteti ekonomik, për arsye të ndryshme, Shteti implikohet në raste të caktuara drejtpërsëdrejti në prodhimin e të mirave materiale apo shërbimeve duke operuar si çdo agjent tjetër ekonomik në treg. Sistemi arsimor apo shëndetësor, furnizimi me energji elektrike apo ujë, transporti publik apo prodhimi i armëve janë vetëm disa shembuj të fushave në të cilat shteti tradicionalisht ka qenë aktiv në ofrimin e produkteve përkatës.

Funksionimi i shtetit si blerës i të mirave materiale dhe shërbimeve në treg. Shteti është gjithashtu një blerës i të mirave dhe shërbimeve në treg, nëpërmjet blerjes së produkteve, që prej letrës, kompjuterave, pajisjeve të zyrave, ushqimit për shkolla e spitale, e deri tek avionët e anijet, shteti influencon drejtpërsëdrejti aktivitetin e sektorit privat, duke kontrolluar kërkesën për produktet e shërbimet që ai ofron.

Funksionimi i shtetit si rregullues i tregut. Shteti ndërhyt në treg për të siguruar rritje të qëndrueshme ekonomike, stabilitet cmimesh dhe rritje të punësimit. Shteti ndikon në mënyrën e funksionimit të sektorit privat përmes: (i) ngritjes dhe mbarëvajtjes së sistemit rregullues të tregut me synim mbrojtjen e konsumatorëve, punonjësve, mjedisit dhe shmangien e praktikave jo-konkurrese dhe diskriminuese, (ii) taksave, subvencioneve dhe kreditimit të cilat zbatohen mbi bizneset, individët dhe çdo njësi tjetër e aktivitetit ekonomik, (iii) dhënies së të drejtave të përdorimit, shfrytëzimit apo zhvillimit të pasurive kombëtare të një vendi.

Roli i shtetit në rishpërndarjen e të ardhurave. Funksioni rishpërndarës i të ardhurave përbën ndër rolet më të hershëm të shtetit. Në ekonomitë moderne mekanizmi rishpërndarës bazohet kryesisht në sistemin e taksimit që mundëson marrjen e të ardhurave nga grupe të caktuara shoqërore, dhe rishpërndarjen e tyre nëpërmjet asistencës sociale, sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo sistemeve të arsimit, etj.

Trashëgimia e institucioneve publike. Edhe në vendet me liberale, ka qenë e pamundur që disa funksione ekonomike shtetërore, të transferohen në duart e sektorit privat. Një rast të cilit i binden të gjitha ekonomitë botërore psh, është funksionimi i bankave qendrore, të cilat janë tërësisht funksion publik i shteteve përkatëse ose grupeve ekonomike të tyre.

4. PËR NJË ZHVILLIM EKONOMIK I QËNDRUESHËM

Në kuadrin e analizave krahasuese dhe gjykimeve të ekspertëve të zhvillimit ekonomik, ekziston një debat i gjerë në kërkim të përgjigjeve për pyetje të tilla, si: përse ekonomitë e disa vendeve performojnë më mirë dhe zhvillohen me ritme të larta e të qëndrueshme në krahasim me vendet e tjera? Përse ekonomia amerikane ecën më mirë se ajo europiane? Përse disa modele ekonomike, edhe në vende të vogla apo në zhvillim, po ndikojnë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërkohë që në vende të tjera, qofshin këto më të mëdha, rezultatet vazhdojnë të jenë mediokre? Përgjigjet e këtyre pyetjeve, po kthehen në politika ekonomike e financiare për veprim, po shndërrohen në filtra për zgjedhjen e strategjive dhe masave më të përshtatshme qeverisëse e klimë biznesi stimuluese e mbështetëse.

Ekspertë kanë identifikuar disa faktorë kryesorë që mund të shërbejnë si manual referues për vendimmarrësit e politikave ekonomike e financiare të vendeve që synojnë të kenë rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme, që kërkojnë rritjen e punësimit, që synojnë hapësira sa më gjera për teknologjitë e reja dhe inovacionin etj. Prej këtyre faktorëve identifikohen si më të rëndësishmit:¹² **Përmirësimi i kulturës së sipërmarrjes; Sistem financiar që mbështet direkt sipërmarrjen; Institute dhe qendra kërkimore cilësore; Tregje pune eficiente; Kulturë dhe modele fiskale që inkurajojnë punësimin cilësor dhe intensiv; Burime të qëndrueshme energjetike; Popullsi dhe fuqi punëtore të mirarsimuar në rritje të vazhdueshme; Shtet i “lehtë dhe eficient” etj.**

5. SHTETI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Një ndër faktet që dëshmon më së miri ngulitjen e një mentaliteti socialist në opinionin publik është fakti që qeveritë e njëpasnjëshme, të cilido krahu, krekosen e lëvdohen para votuesit me shpenzimet buxhetore të bëra, dhe kjo gjë merret e mirëqënë si diçka e dobishme dhe e vlefshme për ekonominë e nuk sfidohet nga kurrkush. Pra ekziston tashmë një bindje, e pasfiduar dhe e palëkundur, se burimi kryesor i begatisë dhe rritjes së mirëqënies shtetërore është në mënyrë të pashmangshme shteti me investimet e tij. Edhe pse sivjet do mbushen tre dekada nga rënia e murit të Berlinit, ende shoqëria jonë nuk e ka kuptuar se motori i vërtetë i zhvillimit ekonomik është sipërmarrja

¹² Adrian Civici, Çfarë kërkon një zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, botuar në Panorama, 12 shtator 2019, <https://shtetiweb.org/2019/09/12/cfare-kerkon-nje-zhvillim-ekonomik-i-qendrueshem/> (28.09.2019)

private në kushtet e ekonomisë së tregut, të një konkurrence të lirë dhe sundimit të ligjit që garanton kontratën dhe pronën private.

Kur dëgjohet retorika e pushtetarëve për investimin këtu e investimin atje, të krijohet përshtypja se po bëhet fjalë për ndonjë bamirës zemërgjerë që po na nderon e respekton me bujarinë e tij. Harrohet që në rastin e shpenzimeve buxhetore bëhet fjalë për paratë tona, pra të thesit tonë të përbashkët, dhe kuptohet sa herë futet dora aty për të bërë ndonjë shpenzim, në rrugë e sipër derdhet një pjesë e majme e sasive të parave tona të përbashkëta për t'u futur në xhepat e këtyre “pushtetarëve bujarë”. Prandaj përpara se të fërkojnë duart e shprehin mirënjohje për investime në infrastrukturë nga qeveria, qytetari i thjeshtë do të duhej që të reflektonte se ku do i merrte këto para qeveria.

Burimet kryesore të shpenzimeve qeveritare janë natyrshëm taksat, huamarrja apo prerja e parave dhe secila prej këtyre alternativave të përdorura për të financuar shpenzimet qeveritare kanë pasoja negative.

Kështu për shembull rritja e taksave në vetëvete dëmton stimujt që kanë qytetarët për tu angazhuar sipërmarrje private, kursim dhe investim.

Kuptohet që ka disa shpenzimet buxhetore që janë të dobishme dhe që kanë një efekt të drejtpërdrejtë pozitiv në zhvillimin e ekonomisë së tregut. Për shembull shtimi i shpenzimeve publike në shtimin e drejtësisë, edhe pse largon para nga sektori produktiv privat, prapëseprapë i kompenson dhe i tejkalon me efektin pozitiv të përmirësimit të sundimit të ligjit. Kjo pasi zbatimi i ligjit, respektimi i kontratës dhe mbrojtja e pronës private janë parakushte për rritjen ekonomike. E njëjta gjë mund të thuhet nëse investohet në përmirësimin e modernizimin e administratës publike duke rritur efikasitetin, profesionalizmin dhe integritetin e saj në dhënien e shërbimeve të domosdoshme për qytetarët dhe bizneset.

Kështu për shembull një ndër kostot më të mëdha të shpenzimeve buxhetore është ajo e deformimit të tregut sepse fondet e hedhura ta zëmë në infrastrukturë bën që më shumë të zhvillohet sektori i ndërtimit në vend që të investoheshin para në sektorin e prodhimit apo në bujqësi e turizëm që janë më të leverdisshëm për ekonominë në tërësi. Për më tepër, duhet patur parasysh se shteti duke qenë konsumatori kryesor dominues në ekonomi i detyron ofruesit e shërbimeve dhe produkteve që t'i përshtaten. Mirëpo nëse për të bindur një konsumator privat, biznesit i duhet që të uli çmimin e rrisi cilësinë duke konkurruar me aktorë të tjerë, për të fituar një tender apo kontratë qeveritare, biznesit i duhet të korruptojë ose të fusi hundët në politikë e të sigurojë favore.

Si zgjidhje për këtë problem më së miri shkojnë për shtat fjalët e Milton Friedman i cili thoshte se “Nevoja jonë themelore afat-gjate është që të ndalojmë rritjen shpërthyesë të shpenzimeve qeveritare. Unë jam i bindur se e vetmja mënyrë efektive për ta bërë këtë është ulja e taksave- në çdo kohë për çfarëdo justifikimi e në çfarëdo mënyre. Arsyeja është se qeveria do të shpenzojë çfarëdo që mbliidhet nga sistemi i taksave e madje edhe më shume se aq”. Përveç uljes së taksave një tjetër politikë shumë efikase për të ulur borxhin publik është padyshim vendosja e një tavani të shpenzimeve buxhetore dhe janë tashmë 23 vende që në një mënyrë a një tjetër kanë vendosur kufizime që pengojnë shtimin galopant të shpenzimeve qeveritare. Shembujt e suksesit të zvogëlimit të dëmit të shpenzimeve qeveritare që vijnë nga Zvicra, Kanadaja, Letonia, Lituania, Zelanda e Re, Irlanda, Sllovakia janë me të vërtetë modele që duhen marrë në konsideratë.¹³

Por njëkohësisht, duhet marrë në konsideratë edhe përfundimi në të cilin del Banka Botërore, se për të zhdukur varfërinë monetare duhet zhdukur varfëria në arsim. Prandaj ajo ka bërë thirrje globale për zhdukjen e varfërisë në arsim. Për këtë ajo thekson nevojën që arsimi fillor të bëhet prioritet. Duke theksuar që: “Në moshën 10-vjeçare të gjithë fëmijët duhet të jenë të aftë të lexojnë dhe të kuptojnë tekstet e thjeshta. Arsimi fillor duhet të jetë prioritet”.¹⁴ Një sipërmarrje e tillë me seriozitet, do të bënte që shteti të bënte veprimin më të sigurt për zhvillimin ekonomik të vendit.

Por që të bëhen mirë detyrat për çështjet e zhvillimit ekonomik duhet që të parandalohen të gjitha dukuritë e ëdmshme. Gjë që mund të arrihet vetëm nëse “... më parë hulumtohen e studiohen në mënyrë të gjithanëshme”.¹⁵ E kjo bëhet kur e kemi të qartë se: “Ekonomia dhe sistemi ekonomik i një vendi janë segmente me rëndësi vitale të jetës shoqërore. Bazuar në rëndësinë, që ka ekonomia për mirëqenjen shoqërore, shteti angazhohet që të krijoj politikë ekonomike e cila i përshtatet nevojave dhe interesave shoqërore”. Pikërisht kjo është ajo që pritet dhe që ba krijon bindjen e sigurisë së të ardhmes. Por kjo bëhet e mundshme, kur shteti vihet edhe përballë krimit ekonomik, i cili “... ka ndikim të drejtpërdrejt në rënjën e moralit të qytetarëve. Kjo ndodhë për shkak të varfërimit të një shtrese

¹³ <http://atlasi.al/demet-qe-investimet-e-qeverise-i-shkaktojne-ekonomise-dhe-si-mund-te-kufizohen-ato/>
(14.08.2019)

¹⁴ <https://indeksonline.net/%e2%80%8bbanka-boterore-per-te-zhdukur-varferine-monetare-duhet-zhdukur-varferine-ne-arsim/> (16.10.2019)

¹⁵ [Krasniqi Mr.sc.Armand, Ekonomia dhe kriminaliteti ekonomik,](https://www.researchgate.net/publication/288993877_Ekonomia_dhe_kriminaliteti_ekonomik)
https://www.researchgate.net/publication/288993877_Ekonomia_dhe_kriminaliteti_ekonomik

të popullsisë kundërll shtresës tjetër që gati brenda natës pasurohet në mënyrë të kundërligjshme, për shkak të aferave të ndryshme financiare krizave qeveritare etj, të cilat opinioni publik i përcjellë me vigjilencë, por në të shumtën e rasteve është i pafuqishëm ti luftojë shkaqet e tyre”.¹⁶

6. LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR ELEMENTI I SIGURISË SË ZHVILLIMIT

Pa pretenduar të merremi me terrorizmin ndërkombëtar dhe krimin e organizuar si fenomene, duam të evidencojmë se këto janë fuqi shkatërruese dhe vdekjeprurëse, që janë prezent gjithkund dhe as ne në Kosovë nuk jemi të shmangur prej goditjes së tyre.

“Për secilin nga ne është e qartë se terrorizimi e ka ndryshuar mjedisin tonë të sigurisë, duke e rrezikuar gjithnjë e më shumë atë, por në të njëjtën kohë ai ka shtruar nevojën për forcimin e bashkëpunimit”.¹⁷ Dhe ky bashkëpunim nuk duhet kërkuar vetëm në fushën ndërkombëtare. Por në radhë të parë në ndjenjën e përgjegjësisë për ta parë njëri tjetrin drejtë në sy këtu në vendin tonë, në shtetin tonë, në shoqërinë tonë. Dhe e themi këtë sepse kur dëgjojmë që një funksionar i lartë shtetëror e quan funksionarin tjetër terrorist, armik, antishqiptar, hajdut, kriminel, tregëtar të interesave kombëtare, i korruptuar, fallsifikator etj etj. Etiketime që në vijim transferohen në analizat e stërshumta mediatike, ku edhe aty pa asnjë lloje ndjenje përgjegjësie merren përgjegjësi që gazetarët dhe analistët të kthehen thjeshtë në thashemexhi e akuzues, duke marrë kompetencat e prokurorit, të policit, gjykatësit, gardianit etj., lind pyetje: Si të veprojnë qytetari? Kë të besojë? Kë të quaj atdhetar e kë anti atdhetar? Kë të quaj shtetar e kë anti shtetar? Kë të konsideroj hajdut e kë të ndershëm?

Një sjellje e tillë në parlament, në fushata elektorale, në takime, në deklarata mediatike, në biseda, në analiza mediatike etj., bëjnë që njerëzit të ndihen shumë të pa sigurt dhe të mos guxohet të ndërmerren hapa për të investuar e zhvilluar ekonominë, sepse nuk ke kujt t’i besosh.

Në këto kushte do të lulëzojë krimi, sepse: “Terrorizmi dhe krimi i organizuar, natyrisht, ka edhe bazën e vet ekonomiko-financiare. Kjo kryesisht në dukurinë e kontrabandës, në trafiqet ilegale, drogën, pastrimin e parave të pista, evazionin fiskal, zhvillimet e ekonomisë informale etj., që janë përhapur sidomos në vendet ku nuk funksionon shteti ligjor, ku vepron gjerësisht fenomeni i korrupsionit në organet e drejtësisë dhe të administratës publike, ku renditen edhe vendet e Ballkanit”.¹⁸ A jemi ne në këtë bllok? Dëshirojmë të mos jemi, dëshirojmë të mos na afrohet fare ky fenomen shkatërrues, por dyshojmë.

“Krimi i organizuar ekonomik ndërkombëtar përfshin aktivitete të lidhura me krimin ekonomik, prodhimin dhe trafikimin e drogave, trafikimin e qenieve të gjalla, kontrabandën, prodhimin dhe shpërndarjen e parave të falsifikuara dhe dokumenteve të falsifikuara, krimin kibernetik, pastrimin e parave etj”.¹⁹ Prej këtyre fenomeneve as mund të mendohet të mbetemi jashtë. Por ajo që është me vlerë në këtë rast është që të bëhet luftë pa kompromis kundër këtyre pamjeve të krimit, jo të bëhemi pjesë e tij.

Por për këtë është mirë të kemi të qartë faktin se: “Krimi i organizuar ekonomik ndërkombëtar është parakusht i korrupsionit dhe përhapja e tij në rajone problematike rrezikon jo vetëm institucionet rajonale dhe sigurinë rajonale, por paraqet rrezik për sigurinë ndërkombëtare në përgjithësi. Krimi i organizuar ekonomik ndërkombëtar është një prej kërcënimeve kryesore ndaj sigurisë ndërkombëtare, si dhe për sigurinë e qytetarëve dhe për themelet e shoqërisë demokratike”. Ne nuk mund të ngremë një front luftë kundër tyre, por të jemi pjesë serioze e armatës botërore në luftë kundër këtyre dukurive kriminale që na e bëjnë jetën dhe të ardhmen të pa sigurte, duke bërë një qeverisje më të mirë; duke konsoliduar dhe funksionalizuar më mirë institucionet demokratike në vend; duke punuar fortë për zhvillimin dhe përparimin ekonomik e financiar të vendit; duke forcuar e konsoliduar deri në standardet bashkëkohore administratën publike; duke arritur kufizimin maksimal të korrupsionit, kontrabandës, drogës, evazionit fiskal, të ekonomisë informale etj.; duke zhvilluar me forcë dhe pa u ndalur luftën kundër trafiqueve të paligjshme dhe trafikimit të qenieve njerëzore; duke zhvilluar pa kompromis luftën kundër korrupsionit etj.

Pasi të kemi arritur këto që theksuam, megjithatë të jemi të qartë se: “Terrorizmi dhe krimi ekonomik i organizuar është një çështje që nuk i takon vetëm një shteti apo një shoqërie. Asnjë vend dhe asnjë shoqëri nuk mund ta fitojë e vetme betejën kundër terrorizmit apo kundër krimit ekonomik ndërkombëtar. Por së bashku mundemi!”²⁰

¹⁶ [Krasniqi Mr.sc.Armand, Ekonomia dhe kriminaliteti ekonomik,](https://www.researchgate.net/publication/288993877_Ekonomia_dhe_kriminaliteti_ekonomik)

https://www.researchgate.net/publication/288993877_Ekonomia_dhe_kriminaliteti_ekonomik

¹⁷ <https://balkanweb.com/fitorja-e-luftes-kunder-terrorizmit-dhe-krimit-te-organizuar-sfide-e-kohes/> (28.09.2019)

¹⁸ Po Aty,

¹⁹ Po Aty,

²⁰ <https://balkanweb.com/fitorja-e-luftes-kunder-terrorizmit-dhe-krimit-te-organizuar-sfide-e-kohes/> (28.09.2019)

7. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SHETETI I EKONOMISË SË TREGUT

“Nëse i pyet qytetarët e Kosovës se kush është pengesë e zhvillimit ekonomik, besoj se një numër bukur i madh i tyre do të përgjigjen “shteti””.²¹ Dhe këtu ka të vërtetë. Por e vërteta është në të kundërt të asaj çka mendojnë qytetarët e në disa raste edhe intelektualët. Kjo përgjigje vjen si rrjedhojë se qytetarët të mësuar me shtetin pranon të gjithçkaje, shtetin që ka pronë të vetën tokën, bujqësinë, blegtorinë, industrinë, tregëtinë, importin dhe eksportin, caktimin e çmimeve, gjetjen e punës për qytetarët në moshë prej 16 vjeç e deri në moshën e pensionit etj., mendojnë se shteti ka atë fuqi që kishte ai shteti i ekonomisë së centralizuar.

Shteti i ekonomisë së tregut jeton vetë me taksa. E kur shteti jeton me taksa as nuk ka kapacitete për të zhvilluar ekonominë e as ka mundësi të punësojë qytetarët. Prandaj kur shteti merr mbi vete përgjegjësi që janë jashtë kapacitetit të tij, pavarësisht nga dëshira e mirë, ai bëhet pengesë për të zhvilluar ekonominë. Dhe këtu janë bashkuar dy mentalitete të gabuara: Së pari, ai i qytetarëve, të cilët e kërkojnë zgjidhjen te punësimi nga shteti; dhe, së dyti, ai i shtetit, që duke mos pasur fuqi, bën premtime që bien ndesh me funksionalitetin e tij. Dhe të dy palët duket se nuk e njohin ekonominë e tregut, pasi nuk po dinë të gjejnë pozicionin e tyre, e për rrjedhojë po mbetemi të varfër, po mbetemi të pa zhvilluar ekonomikisht e duke e mbajtur vështrimin në zhvillimin e vendeve të tjera dhe në mjaft raste duke i kontribuar atij zhvillimi në vend që të zhvillojmë vendin tonë.

Në kushtet e ekonomisë së tregut, “zakonisht janë korporatat ato të cilat janë ‘miq të ngushtë’ me autoritetet e taksave. Me këtë nivel të korrupsionit në Kosovë nuk do të ishte çudi sikur në realitet numri i korporatave që paguajnë taksa të jetë shumë i vogël. Si rezultat, nevoja e mbulimit të taksave largohet prej të pasurve që kanë korporata në ata të varfrit që janë punëtorë të thjeshtë, e të cilëve mungesa e lidhjeve me pushtetin ua pamundëson mbrojtjen e të ardhurave”.²² Kjo është një çështje që tërheq vëmendjen, që është bërë dhe bëhet çdo ditë objekt i debateve punlike, por që askush nuk po ndalet të marrë masat e nevojshme, që të gjithë të bëhen të barabartë para ligjit. Për rrjedhojë shihet sot, se ai që nuk i zgjidh dot problemet që i lindin është qytetari; ai që ka pak të ardhura është qytetari; ai që po i ndodhi një fatkeqësi nuk gjenë dot rrugë për të dalë nga situata e krijuar është qytetari; ai që po u sëmure duhet të vdesë se nuk ka mundësi të shërohet është qytetari; ai që e ndëshkon ligji është qytetari; ai të cilit i vë gjobë polici është qytetari; ai duhet të presë në radhë për një dokument në zyrat e shtetit për kohë të pacaktuar është qytetari; ai që duhet të paguaj taksat është qytetari etj. Ndërsa të tjerët bien në sy më pak, sepse ata nuk gjobiten në rrugë; nuk rrinë në radhë; nuk paguajnë taksa; nuk rrinë korridoreve të spitaleve, se shërohen në klinika të specializuar, kryesisht jashtë shtetit; nuk kanë problemet për t’i zgjidhur, se ua zgjidhin të tjerët; nuk përballen me ligjin, se ligji ikën prej tyre etj. Pikërisht ky është problemi që duhet të zgjidh shteti, e jo të merret me gjetjen e punës për disa, duke lënë në harresë të gjithë të tjerët.

Një çështje tjetër që meriton vëmendje në rrugën e zhvillimit të vendit, është ajo e vendosjes së raporteve të pranueshme midis eksportit dhe importit të mallrave. Ne e dimë se: “Në fazat më primitive të njerëzimit, individët kanë synuar t’i prodhojnë vetë të mirat dhe shërbimet që u janë nevojitur. Mirëpo gjatë zhvillimit shoqëror, ata e kanë kuptuar se kjo është pothuajse e pamundur dhe se u duhej një sistem tjetër ekonomik. Me evoluimin e veprimit njerëzor, u lind prirja e individit të prodhojë të mira për tjerët, që ato pastaj t’i shkëmbej me të mirat për të cilat ka nevojë”.²³ Por si duhet dhe mund të bëhet ky shkëmbim, që të gjithë të kenë mall për shkëmbim dhe para për të blerë mallin që nuk e prodhojnë. E për këtë është tregëtia si brenda vendit ashtu edhe ajo ndërkombëtare, e cila “nuk është asgjë tjetër përveç tregtisë së individëve përtej kufijve, prej vendit A në një vend tjetër B”.²⁴ Por këtu ka një ndryshim, pasi vendi ynë nuk prodhon para. Nëse do të krijohen një mundësi që të prodhoheshin vetëm para, do të ishte puna mirë. Por zakonisht paratë i prodhon malli. Vetëm kur ke mall, mund të fitosh para, të cilat natyrisht do t’i shkëmbesh prapë me mall. Prandaj kur është fjala për tregëtinë ndërkombëtare, duhet që me vlerën monetare të eksporteve, të mbulohen të gjitha shpenzimet për importe. Kjo për arsye se “është i nevojshëm që vendi të mos përfundojë vetëm si “blerës” por edhe si prodhues, ...”.²⁵ Po cila është gjendja në Kosovë sot? Sa ne po punojmë që të jemi prodhues konkurrues në tregun ndërkombëtar? Sa shteti po i kushton vëmendje këtij problemi, duke kërkuar me forcë që të ikim nga kafenet e të prodhojmë? A është kjo detyra e shtetit, që të planifikojë të ardhmen e vendit, e cila nuk është e sigurt pa prodhim, pa cilësi prodhimi, pa krijim niveli të zhvillimit e prodhimit ku prodhuesit vendorë të

²¹ Salihu Bardhyl, *Kush po e pengon zhvillimin ekonomik të Kosovës? (Analizë e pasojave negative të shtetit në ekonomi)*, <https://analizaekonomike.wordpress.com/2010/11/14/kush-po-e-pengon-zhvillimin-ekonomik-te-kosoves-analize-e-pasojave-negative-te-shtetit-ne-ekonomi/> (20.09.2019)

²² Salihu Bardhyl, *Kush po e pengon zhvillimin ekonomik të Kosovës? (Analizë e pasojave negative të shtetit në ekonomi)*, <https://analizaekonomike.wordpress.com/2010/11/14/kush-po-e-pengon-zhvillimin-ekonomik-te-kosoves-analize-e-pasojave-negative-te-shtetit-ne-ekonomi/> (20.09.2019)

²³ Po Aty,

²⁴ Po Aty,

²⁵ Po Aty,

kenë mundësinë të përballen me konkurrencën e prodhuesve të huaj? Pikërisht këtyre çështjeve duhet t'u japë përgjigje dhe zgjidhje shteti, për të mos u bërë pengesë e zhvillimit, por për t'u bërë nxitës i tij.

“Është e pamundur të blesh nëse nuk ke para, dhe është e pamundur të kesh para nëse nuk prodhon”.²⁶ Është shumë e prapambetur ideja, që duke punuar në emigracion, të importojmë para në Kosovë dhe duke eksportuar këto para prej Kosove, të blejmë mallin që na nevojitet, megjithëse këtë mall mund ta kishim prodhuar shumë më të sigurt e të bollshëm vetë. Prandaj ajo që nevojitet për zhvillimin ekonomik të vendit është orjentimi i biznesit për të shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e vendit, për të prodhuar të mira materiale, duke konkuruar në tregun ndërkombëtar, ku shteti duhet të mos pengojë prodhimin dhe shkëmbimin e mallrave, por të kontrollojë dhe të hapë fusha të veprimtarisë së bizneseve për të balancuar eksportet me importet. Dhe për këto nuk kërkohet që në Kosovë të krijohen rrugë të reja për të gjetur mirëfunktionimin e elementëve të zhvillimit ekonomik të vendit, por thjeshtë të njihen dhe të zbatohen përvojat e shteteve të zhvilluara, të cilët atë që duam të arrijmë ne tani e kanë arritur disa dhjetra vjeçare më herët.

Prandaj kërkohet të jetë fusha e hapur, të ketë sa më shumë konkurrentë, shteti nuk duhet të monopolizojë akreditimet e licensimet. Gjithkush duhet të ketë akses për t'u marrë me një biznes, sepse një praktikë e tillë do t'i detyrojë bizneset ekzistuese të rritin nivelin e punës, të cilësisë së prodhimit dhe të teknologjisë, për të qëndruar në treg, pasi i riu a të rinjtë që vijnë, mund të rezultojnë me të suksesshëm.

“Çdo veprim ekonomik është veprim njerëzor i individëve të cilët përdorin mjete për t'i përmbushur dëshirat dhe nevojat në tentim për ta përmirësuar jetën e tyre”.²⁷ Por jo çdo veprim është edhe i mirë. Kur një ndërmarrje privatizohet për t'u funksionalizuar dhe shkatërrohet e tjetërsohet, ky nuk është veprim i mirë. Kur blihet një minier dhe nuk investohet fare në të por thjeshtë shfrytëzohet, duke çuar edhe në aksidente e edhe në katastrofa që kërcënojnë a marrin jetë njerëzish, nuk është ky një veprim i mirë. Kur ngrihet një kompani biznesi dhe punëtorët paguhen thjeshtë sa për të thënë, me një pagë jo minimale, por qesharake, as ky nuk mund të thuhet se është veprim i mirë. Kur i vihat zjarri pyllit për t'i ulur vlerën që të blihet thuajse me çmime formale, nuk dimë si mund të quhet ky veprim i mirë. Kur në të gjitha anët priset mjedisi i vendit duke krijuar vatra të prodhimit të gurëve, rërave, mermerëve etj., pa vlerësuar se janë edhe qytetarët me të drejta mbi atë mjedis dhe ajërin që e ndotin, nuk dimë si mund të quhet ky veprim i mirë. E të gjitha këto dhe mjaftë të tjera janë nën sytë e shtetit. Kështu duket se për zhvillimin ekonomik duhet shumë punë për të krijuar sigurinë e ecurisë së zbatimit të ligjeve njerëzore, qytetare, shoqërore, sociale, shëndetësore, të punës, të mjedisit etj., që në fund të jenë të kënaqur të gjithë. Por këtë e bën shteti qytetar i shtetit. Këtë nuk mund ta bëjë shteti vagabond e kriminel, që kushtet bizneseve ua vë për interesat personale, familjare e klanore dhe as që kujtohet për interesat qytetare, të zhvillimit e sigurisë së asaj që është arritur me synimin për të ecur me besim më tej.

Prandaj edhe përcaktohen rreziqet. Rreziqet e jashtme dhe të brendshme, përballë të cilave vihat gjithë potenciali i shtetit për të pasur stabilitet politik, për të pasur forcë të organizuar për të mbrojtur lirinë, pavarësinë dhe integritetin territorial të shtetit; si dhe për të pasur forcë të organizuar e të profesionalizuar për të siguruar rendin, qetësinë e sigurinë dhe për të qëndruar fortë përballë çdo akti që bie ndesh me ligjet e shtetit, pavarësisht cili është shkelësi i ligjit, qytetari i thjeshtë, kriminel i fortë a qeveritari kupolë.

8. MBI DOMOSDOSHMERINË E NJOHJES DHE ZHFRYTËZIMIT TË MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE

Pasi kemi trajtuar disa çështje të zhvillimit ekonomik, për të cilat bëjmë përpjekje të aftësojmë studentët e Kolegjit Biznesi, të cilët pretendojnë të jenë specialistët e të ardhmes për Kosovën, do të trajtojmë në vijim disa elementë të Menaxhimit të Emergjencave, pasi i konsiderojmë të domosdoshme për t'u studiuar nga studentët, institucionet, intelektualët e qytetarët, sepse vetëm kështu arrijmë për të krijuar një pamje sa më të qartë për fatkeqësitë që paraqiten në jetën shoqërore e që shkaktojnë dëme në jetën e qytetarëve dhe në pasurinë e tyre, si dhe në pasurinë shoqërore e në mjedisin jetësor.

Menaxhimi i emergjencave konsiderohet si fusha më e gjerë dhe gjithëpërfshirëse për ardhmërinë e veprimtarisë shoqërore, sepse merr përsipër të paraqesë përgjithësisht teorinë dhe praktikën e situatave të emergjencave dhe menaxhimit të tyre.

Në botën moderne shërbimi i emergjencave ka pasuar zgjerim të përmasave shumë të mëdha, duke hedhur hapa drejt marrjes nën drejtim të gjithë spektrit të veprimtarisë së shoqërisë në situata të veçanta.

²⁶ Salihu Bardhyl, *Kush po e pengon zhvillimin ekonomik të Kosovës? (Analizë e pasojave negative të shtetit në ekonomi)*, <https://analizaekonomike.wordpress.com/2010/11/14/kush-po-e-pengon-zhvillimin-ekonomik-te-kosoves-analize-e-pasojave-negative-te-shtetit-ne-ekonomi/> (20.09.2019)

²⁷ Po Aty,

Menaxhimi i Emergjencave studion njohuritë bazë për hapësirën, mjedisin, shoqërinë dhe veprimtaritë kryesore të shoqërisë, të cilat prodhojnë fatkeqësi dhe dëmtime të jetës së njerëzve dhe pasurisë së tyre, si dhe dëmtime të mjedisit e të pronës shoqërore etj.

Në programet që zhvillojmë ne në Kolegj me studentët e Menaxhimit të Emergjencave merren në evidencë fatkeqësitë që prodhojnë situatë emergjence dhe krijohen hapësirat e duhura për të përcaktuar karakteristikat e atyre fatkeqësive që përbejnë emergjenca dhe për të cilat kërkohet të përpilohen plane e të ngrihen struktura udhëheqëse e forca operacionale.

Nëpërmjet dhënies së njohurive për menaxhimin e emergjencave, kërkojmë të njohim dhe të aftësojmë kuadro e menaxherë për situatat e rënda që mund të krijojnë për qytetarët, pronat e qytetarëve, pronat publike dhe mjedisin, si Tërmetet; Përmbytjet; Bllokimet nga dëbora dhe ngricat; Rrëshqitjet e tokës; temperaturat e larta dhe Zjarret; Aksidentet industriale dhe teknologjike; Sulmet terroriste; Aksidentet e mëdha tokësore, ajrore dhe detare; Epidemitë; Konfliktet luftarake; Shkaqet Sociale dhe lufta kibernetike etj.

Duke njohur burimet e lindjes së fatkeqësive për shoqërinë, jetën dhe pronën e qytetarëve, lind vetiu nevoja për t'u njohur me rrugët që duhen ndjekur për t'i parandaluar, lehtësuar dhe menaxhuar këto fatkeqësi, nëpërmjet procesit të menaxhimit të emergjencave. Ashtu sikurse nevoja për të marrë dhe zbatuar masa për t'i parandaluar fatkeqësitë për qytetarët dhe mjedisin e pasuritë e tyre, si dhe gjatë menaxhimit të situatave të krijuara, kur me gjithë masat parandaluese tashmë fatkeqësia ka goditur qytetarët dhe pronat e tyre e mjedisin tonë, të cilin jemi përpjekur ta bëjmë sa më të përshtatshëm për një jetesë normale për njerëzit duke bërë përpjekje për të arritur standardet e kohës.

Dihet që menaxhimi i emergjencave është një detyrë e vështirë. Operacionet e emergjencave janë komplekse. Brenda tyre përfshihen një seri veprimtarish që duhen koordinuar, duke realizuar bashkëpunimin e forcave, të cilat vijnë nga drejtime, detyra e profesione të ndryshme. Prandaj të marrësh përgjegjësi për të drejtuar një operacion, si dhe menaxhuar një emergjencë kërkohet karakter i fortë dhe i qëndrueshëm. Pikërisht për ta bërë të qartë këtë përgjegjësi dhe ngarkesë të madhe e të veçantë janë këto programe, që hapin horizont dhe krijojnë vizion për përballimin e këtyre situatave të ngarkuara dhe të kombinuara, në interes të sigurisë së jetës së qytetarëve e të pasurisë së tyre, si dhe për mbrojtjen e mjedisit e pronës shoqërore.

Sot në botë menaxhimi i emergjencave trajtohet si fushë prioritare e dijeve të specialistëve, në të gjitha hallkat e qeverisjes dhe të institucioneve. Te ne duket se akoma nuk është trajtuar në masën e duhur. Kolegji BIZNESI me programet që zhvillon po bën një tentativë, për të hedhur bazat për të krijuar një portret të teorisë dhe praktikës për të marrë dijet e nevojshme që të kemi kuadro të kësaj fushe, e cila konsiderohet fusha që krijon njerëz me përgjegjësi për momentet kur të gjithë janë në nevojë, në stres, në fatkeqësi, nën efektet e plagëve, të humbjeve materiale, të humbjes së anëtarëve të familjes, të pasigurisë, të vazhdimësisë së goditjeve prej fatkeqësive dytësore e më shumë, të qenies nën goditjet e krimit që gjallërohet në raste fatkeqësish, të dukjes së elementeve të terrorizmit, të kërcënimit të jetës së vetë drejtuesve dhe menaxherëve, të tej lodhjes, të ballafaqimit masivisht me njerëz që kanë humbur shpresën, etj. Në një pamje të tillë menaxheri i emergjencës duhet të ruaj qetësinë, të japë zgjidhje, të gjej rrugë për të shpëtuar njerëzit, të siguroj jetesën e qytetarëve pa strehë, të lëvizë e shpërngule familjet, të kuroj të plagosurit, të sigurojë e ruaj ata që kanë humbur mendjen, të parandalojë krimin, të likuidojë pasojat dhe të ruaj ekuilibrin për vete, pa e humbur për asnjë moment përqendrimin në detyrat prioritare edhe kur njerëzit qajnë, edhe kur ulërijnë, edhe kur kërcënojnë, edhe kur ikin, edhe kur nuk binden, edhe kur fshihen punonjësit që janë në operacion, edhe kur lindin efekte dytësore të fatkeqësisë, edhe kur ka përballë dhjetëra të vdekur, edhe kur spitalet janë goditur nga fatkeqësia, edhe kur telefonat nuk punojnë, edhe kur mediat bëjnë shaka ose akuzojnë, edhe kur eprorët nuk përgjigjen, edhe kur mungojnë ndihmat etj.

Bazuar në gjithë këto veçori, duket pra se menaxheri i emergjencave është një personalitet i cili është përgjegjës për të vënë në lëvizje të gjitha ato organizata që punojnë për parandalimin e fatkeqësisë, përballimin e saj kur ajo ndodhë, mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike në situata të tilla, shpëtimin e jetës së njerëzve, shpëtimin e pasurisë së qytetarëve e atë shoqërore, mbrojtjen e ambientit, zbulimin dhe parandalimin e krimit, sigurimin e integritetit dhe pavarësisë së vendit në situatë fatkeqësie, kurimin e të plagosurve, strehimin e të pastrehëve, shkollimin e fëmijëve dhe të rinjve, varrimin e të vdekurve, pastrimin dhe dezinfektimin e ambientit, kthimin e shpresës të qytetarët dhe normalizimin e situatës etj. Me një detyrë kaq të rëndësishme, ky menaxher duhet të bëjë një menaxhim efikas dhe veçanërisht të mirë për të qenë i suksesshëm e për të krijuar besim të qytetarët në nevojë.

Për menaxherin e emergjencave, prioritet mbetet gjithmonë parandalimi i fatkeqësive. Prandaj në çdo planifikim kërkohet gjithnjë që kapitulli i parë dhe më i rëndësishmi të jetë kapitulli i veprimtarisë intensive menaxheriale, administrative, politike, strategjike, organizative, operacionale dhe të sigurisë, pastaj të planifikohen kapitujt e tjerë të përgjigjes, por vetëm pasi të kemi planifikuar të gjitha masat e mundshme të parandalimit. Për këtë përgjegjësi e strukturave të përhershme të sigurisë mbetet baza e suksesit.

Përmbajtja e programeve të Kolegjit BIZNESI për menaxhimin e emergjencave është e bazuar në arritjet e fundit shkencore në botë për aq sa kemi arritur të njohim, por edhe në vendin tonë, si dhe në përvojat që ne dhe të tjerët

kemi krijuar gjatë ballafaqimit me fatkeqësitë natyrore e edhe të shkaktuara nga dora e njeriut. Në këto programe jemi përpjekur të krijojmë një fushëpamje e cila do të paraqes dhe të sqarojë konceptet themelore që nevojiten për të funksionuar sistemi i përballjes me fatkeqësinë, që përfshin punën e menaxhereve, drejtuesve të operacioneve, forcave operacionale, si dhe në çdo kohë mbështetjen e vullnetit politik të vendit.

Janë bërë përpjekje të arsyetohet se mund të kesh gjithçka që nevojitet, por nëse nuk kemi një menaxher të emergjencës, të zgjuar, trim, profesionist të mirë, të vendosur, me karakter të fortë, të shkathtë, komunikues, pa emocione, të dashur, të rreptë, të drejtë dhe human, nuk mund të kemi një operacion emergjencash të suksesshëm. Pra, menaxheri përbën bazën e suksesit në situatë emergjence. Ashtu sikurse Menaxhimi i emergjencave përbën bazën e sigurisë së nivelit të arritur të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

LITERATURA

Civici, A., (2019) Çfarë kërkon një zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, botuar në Panorama, <https://shtetiweb.org/2019/09/12/cfare-kerkon-nje-zhvillim-ekonomik-i-qendrueshem/> (28. 09.2019)

Hoxha, B., (2019) <https://www.monitor.al/reshjet-kostot-dhe-perfitimet-ne-ekonomi/>

Kabashi, S., Shehu, I., Lama, K., (2015) Fjalor shpjegues i termave të menaxhimit të emergjencave, Kolegji BIZNESI, Prishtinë, faqe 820 - 821

Krasniqi, A., Ekonomia dhe kriminaliteti ekonomik, (n.d.) https://www.researchgate.net/publication/288993877_Ekonomia_dhe_kriminaliteti_ekonomik

Salihu, B., (2010) *Kush po e pengon zhvillimin ekonomik të Kosovës? (Analizë e pasojave negative të shtetit në ekonomi)*, <https://analizaekonomike.wordpress.com/2010/11/14/kush-po-e-pengon-zhvillimin-ekonomik-te-kosoves-analize-e-pasojave-negative-te-shtetit-ne-ekonomi/> (20.09.2019)

<https://www.monitor.al/dobesimi-i-rritjes-ekonomike-dhe-trazirat-politike-demin-me-te-larte-ne-ekonomi/> (16.09.2019)

<https://www.monitor.al/dobesimi-i-rritjes-ekonomike-dhe-trazirat-politike-demin-me-te-larte-ne-ekonomi/> (16.09.2019)

<https://shtetiweb.org/2012/12/29/roli-i-shtetit-ne-ekonomi/> (25.10.2019)